

Në bazë të nenit 20 dhe nenit 25 të Ligjit për shërbim gjyqësor (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 43/14, 98/15, 6/16, 198/18 dhe 248/18) dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.167/15, 27/16, 120/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 110/19, 267/20, 151/21 dhe 288/21), Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Pëlqimit nga Ministria e financave nr. 18 – 8899/2 të datës 22.09.2022

## **GJYKATA SUPREME EREPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

**shpall**

### **SHPALLJE PUBLIKE NUMËR 3/2022**

#### **për punësim të 1 (një) personi për kohë të pacaktuar**

#### **1. Mirëmbajtës të higjienës – 1 (një) realizues**

-Certifikatë ose vërtetim me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

#### **Kushtet për kryerje të punëve:**

Arsim të mesëm të kryer, me ose pa përvojë pune.

Lutja, krahas dëshmimeve është e obligueshme të përmbajë: emër dhe mbiemër të kandidatit, vendbanim, gjegjësisht vendqëndrim të kandidatit, e – mail adresë ose telefon për kontakt.

Orari javor i punës është 40 orë (e hënë – e premte);

Orari ditor i punës është 8 orë, prej ora 13:30 deri në orën 21:00

Rroga neto në vlerë: 18.000,00 denarë

Afati për parashtrimin e lutjes është 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit të fundit të shpalljes në gazetën ditore (duke mos llogaritur ditën e vet publikimit).

Krahas kushteve të theksuara të posaçme, të parapara me Rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, kandidatët për vendet e theksuara të punës duhet t'i përmbushin edhe kushtet e përgjithshme të parapara në nenin 21 paragrafi (1) të Ligjit për shërbim gjyqësor:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive të njej gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës madhore
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e theksuara në shpalljen, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Vërejtje: Kandidati i cili do të parashtrorë të dhëna të rrejshme do të diskualifikohet nga procedura e mëtejshme.

Kandidatët e interesuar, obligohen që të parashtrorë Lutje të plotësuar për punësim me dëshmitë për plotësim të kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës në të cilin paraqiten në origjinal ose kopje të vërtetuara në Noter:

- Certifikatë për arsimin e kryer përkatës
- Dëshmi për përvojë pune
- Certifikatë të shtetësisë
- Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore

Lutjet e dorëzuara pas afatit, jo plotësisht të plotësuara, të pa rregulluara dhe të pa kompletuara, nuk do të shqyrtohen.

Lutjen me dëshmitë, kandidatët obligohen që t'i dorëzojnë drejtpërdrejtë në sportelin për pranimit të dokumenteve në Gjykatë, gjatë orarit të punës ose përmes adresës postare:

## **GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

**Bul. Kërste Misirkov nr.8 Shkup**

**(me shenjë për Shpallje publike numër 3/22)**

Zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në afat të caktuar në nenin 23 paragrafi (2) nga Ligji për marrëdhënie pune.